



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

VENDIM

Nr 5, Datë 24. 12 2019

Për

Dhënien e Lejes për Mbushjen me Ujë për Herë të Parë të Rezervuarit dhe Vënien në Ngarkesë të Digës së HEC-it Osoja

Në zbatim të pikës dh, neni 4, kreu II, të ligjit nr.8681, datë 02.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin, dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, neni 8, 1.3, të “Rregullores për sigurinë e digave dhe dambave”, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) dhe Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave (KTPD), në mbledhjen e tij të datës 24.12.2019, mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “Osoja-HPP” sh.p.k për dhënien e lejes të mbushjes për herë të parë të rezervuarit, sipas shkresës nr. 27 datë 19.12.2019, si dhe kolaudimit të punimeve të Digës në Hec-in Osoja, të përgatitura nga ing. Saidjon Kodhelaj.

Në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata e lidhur me MIE nr.1755 rep, nr.776/1 kol datë 25.07.2017 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e Hec-it Osoja me kapacitet prodhues 1.952 MW, në lumin Osojës, degë e lumit Devoll, Korçë në Bashkinë Maliq, Qarku Korçë në datën 18.12.2019 kanë përfunduar punimet për ndërtimin e Hidrocentralit Osojë.

Pas përmbylljes të të gjitha punimeve, në zbatim të legjislacionit të digave/dambave në fuqi, si dhe në prani të përfaqësuesve të shoqërisë sipërmarrëse “Favina” sh.p.k me licencë në zbatim NZ.1689/10 në prani të shoqërisë mbikqyrëse të punimeve, “KKG-Projekt” sh.p.k me licencë MK.2533/4 është bërë kolaudimi i veprës nga shoqëria “6D-PLAN” sh.p.k. me licencë MK.2837/5 kolaudator Sedion Kodhelja.

Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton që nuk janë bërë ndryshime nga projekti i miratuar. Mbas diskutimeve KKDM:

V E N D O S :

Të japë lejen për mbushjen me ujë për herë të parë të rezervuarit dhe vënien në ngarkesë të digës së Hec-it Osoja duke mbajtur parasysh për sa vijon :

1. Shoqërisë Osoja-HPP sh.p.k para fillimit të procedurave të mbushjes me ujë të rezervuarit të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë

Brendëshme, Ministrinë e Bujqësisë, si dhe organet përkatëse të pushtetit vendor në rajonin e ndërtimit të digës, (Neni 25 pika 2,4 e VKM 147 datë 18 .03.2004).

2. Pavarësisht se kjo digë është vetëm nivelngritëse për Hec-in e Osojës, duhet ti kushtohet rëndësi vrojtimit të deformimeve ose plasaritjeve në digë nëse do të ndodhin dhe këto të pasqyrohen në aktin përfundimtar të kolaudimit i cili duhet të hartohet mbas 6 muajve të parë të shfrytëzimit.
3. Si për periudhën 6 mujore ashtu dhe në vijim, shoqëria Osoja HPP shpk duhet të mbajë të informuar shoqërinë Devoll Hydropower në rast të krijimit të situatave që mund të jenë shqetësuese për digën e Osojës. Kjo për qenjën e rezervuarit të Hec Moglicë poshtë digës së Hec Osojës.
4. Shoqëria “Osoja-HPP” sh.p.k brenda vitit të parë të shfrytëzimit të dorëzojë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë “Rregulloren teknike të kontrollit shfrytëzimin e mirëmbajtjen e digës Osojë.

Për/Maksim Muçin

Fatos Hoxha

N/K R Y E T A R